



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

BURSA STUDIMI NË KINË VITI AKADEMIK 2022-2023

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës Popullore të Kinës për vitin akademik 2022-2023 ofron 2 (dy) bursa të plota në universitetet publike të Kinës. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë nëpërmjet postës në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dokumentet sipas kërkesës së palës kineze në informacionin bashkëlidhur, sipas listës në vijim:

1. Formulari i aplikimit për bursë i qeverisë kineze (në gjuhën kineze ose angleze) i plotësuar nga aplikanti.
2. Kopja e faqes kryesore të pasaportës.
3. Diploma më e lartë e noterizuar: Kandidatët duhet të paraqesin një vërtetim të statusit të studentit nga universiteti i tyre aktual. Aplikantët që janë në ndjekje të gjimnazit duhet të dorëzojnë vërtetimin e notave për dy vitet e para të shkollës së mesme. Aplikantët që janë në ndjekje të gjimnazit duhet të dorëzojnë vërtetimin e notave për dy vitet e para të shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar ose Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Aplikantët që kanë përfunduar gjimnazin duhet të dorëzojnë diplomën e Maturës Shtetërore dhe vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar ose Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.
4. Dokumentet në gjuhë të ndryshme nga gjuha kineze ose angleze duhet të bashkëngjiten me përkthime të noterizuara në gjuhën kineze ose angleze.
5. Vërtetim notash të rezultateve të deritanishme: vërtetimet në gjuhë të ndryshme nga gjuha kineze ose angleze duhet të bashkëngjiten me përkthime të noterizuara në gjuhën kineze ose angleze.
6. Një plan studimi ose propozim kërkimi në gjuhën kineze ose angleze.
7. Letrat e rekomandimit: Aplikantët për programe pasuniversitare ose programe të shkollës së lartë duhet të paraqesin dy letra rekomandimi në gjuhën kineze ose angleze nga profesorë ose profesorë të asociuar.
8. Kërkohet nga aplikantët për studime muzikore të paraqesin punimet e tyre. Aplikantët për programet e arteve figurative duhet të paraqesin punimet e tyre të cilat përfshijnë dy skica, dy piktura me ngjyra dhe dy punime të tjera. **Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al**
9. Aplikantët nën moshën 18 vjeç duhet të paraqesin dokumentet e vlefshme të kujdestarëve të tyre ligjorë në Kinë.
10. Aplikantët që planifikojnë të qëndrojnë në Kinë për më shumë se 6 muaj duhet të paraqesin një fotokopje të formularit të kontrollit shëndetësor të huaj të plotësuar në anglisht (kopja origjinale duhet të mbahet nga aplikanti). Formulari i hartuar nga autoriteti kinez mund të shkarkohet nga <http://www.csc.edu.cn/studyinchina> ose www.campuschina.org . Kontrolli shëndetësor duhet të mbulojë të gjitha pikat e renditura në Formularin e Kontrollit Shëndetësor për të Huaj. Regjistrimet jo të plota, ato pa nënshkrimin e mjekut që e plotëson, ato që nuk kanë vulën zyrtare të spitalit ose që janë pa fotografi të vulosur të aplikantëve do të jenë të pavlefshme. Ju lutemi zgjidhni kohën e duhur për të bërë ekzaminimin fizik pasi rezultati është i vlefshëm për vetëm 6 muaj. Dokumentet e mëposhtme duhen paraqitur vetëm nëse është e mundur:
11. Letër para pranimit nga universitetet e Bursave të Qeverisë Kineze.

12. Certifikata e kualifikimit të gjuhës. p.sh., certifikatat HSK, IELTS ose TOFEL. Sqarojmë, se me postë duhet të dërgohen vetëm kopjet e noterizuara të dokumentacionit të kërkuar. **Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është 4 mars 2022.** Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, tarifën e shkollimit dhe siguracionin shëndetësor. Ndërsa shpenzimet udhëtimit duhet të mbulohen nga vetë kandidatët.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialeve informativë (bashkëlidhur) dhe adresave në web-site:

<http://www.campuschina.org>;

<http://www.csc.edu.cn/studyinchina>

<http://www.campuschina.org/universities/index.html>

www.campuschina.org;

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS